



Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi Përmbledhje për Fëmijë



Norwegian Embassy



UNITED NATIONS
ALBANIA

unicef
for every child

75



Norwegian Embassy



UNITED NATIONS
ALBANIA



Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Përmbledhje për Fëmijë

Tiranë, dhjetor 2021

Ky botim u realizua me mbështetjen e zyrës së UNICEF-it në Shqipëri, përmes Fondit të Përsheptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB Shqipëri

Botimi ndihmon në realizimin e këtyre Objektivave:



Materiali u punua nga:

Iva Zajmi, eksperte për Kuvendin dhe Institucionet për të Drejtat e Njeriut, UNICEF

Materiali u rishikua nga:

Robert Gajda, Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ardiana Hala, Drejtore e Drejtorisë Juridike, Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi


Emira Shkurti, Specialiste e Drejtësisë për të Mitur dhe Pikë Fokale për Barazinë Gjinore, UNICEF


Çfarë është diskriminimi?

Diskriminimi është dallim, veçim ose trajtim i padrejtë që na bëhet. Diskriminimi lidhet me atë çfarë jemi ose me origjinën tonë. Diskriminimi ndëshkohet me ligj. Trajtimi i barabartë mbrohet në Kushtetutën e vendit tonë dhe në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Mosdiskriminim do të thotë trajtim i barabartë nga ligji, mundësi të barabarta nga shteti dhe shoqëria dhe masa për të ndaluar shkeljet dhe dallimet e padrejta.

Shkaqet e diskriminimit

Askush nuk ka të drejtë të na dallojë, veçojë, trajtojë padrejtësisht, pavarësisht se cilët janë prindërit tanë, për shkak të moshës që kemi, të racës, të kombësisë së cilës i përkasim, ngjyrës së lëkurës, gjuhës që flasim, pse jemi djalë apo vajzë, për mënyrën se si shprehim identitetin tonë gjinor, për shkak të orientimit tonë seksual, për bindjet politike, mendimet dhe qëndrimet tona publike, për shkak të besimit fetar që vendosim të përqafojmë, për shkak se mund të jemi prekur nga HIV/SIDA apo ndonjë sëmundje tjetër, për shkak të origjinës nga vijnë apo edhe vendbanimit, të familjes që i përkasim, të aftësisë së kufizuar, pamjes së jashtme apo për çfarëdo shkak tjetër për të cilin mund të diskriminohemi.





Llojet e diskriminimit

Diskriminim i drejtpërdrejtë është kur ne trajtohemi ndryshe nga njerëzit e tjerë vetëm për shkak të cilësive tona të veçanta apo për shkak të grupit shoqëror nga vijnë.

Diskriminim i tërthortë është atëherë kur një rregull ose kriter është hartuar në atë mënyrë që mund ta përmbushin vetëm disa persona por jo të gjithë, veçanërisht jo ata që nuk kanë mundësi.

Diskriminimi mund të jetë edhe i shumëfishtë, pra të ndodhë për shumë shkaqe së bashku. Edhe gjuha e urrejtjes që është formë e të shprehurit në publik, e cila shqetëson, fyen, kërcënon një person apo një grup personash përbën diskriminim. Shqetësimi, përfshi ai seksual i cili krijon një mjedis frikësues, armiqësor, poshtërues a fyes është diskriminim dhe ndëshkohet. Edhe të veçosh mënjane një grup fëmijësh vetëm pse janë në pakicë, se kanë ngjyrë lëkure tjetër, apo flasin gjuhë tjetër është diskriminim dhe ndalohet. Mospërshtatja e mjediseve dhe veprimtarive që edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të ndjekin shkollën, të shkojnë në bibliotekë, qendër shëndetësore, etj. po ashtu është diskriminim.

Nuk quhet diskriminim trajtimi mbrojtës që iu bëhet atyre që kanë më shumë nevojë, p.sh.: grave shtatzëna, të moshuarve, ose fëmijëve për t'i mbrojtur ata.

Pasojat e diskriminimit

Nga diskriminimi njerëzit mund të mbeten pa shkollim, të mos marrin dot shërbimet shëndetësore, pa ndihmë ekonomike e shoqërore, pa punë dhe pa strehim në një shtëpi, pa zhvillim dhe pa realizuar gjithë potencialin dhe aftësitë e tyre për të jetuar.

Format më të përhapura të diskriminimit

Diskriminimi në fushën e punësimit. Ndalimi i diskriminimit në punësim kërkon që marrja në punë, kushtet e punës dhe shpërblimi të jenë të njëjtë për të gjithë. Asnjë punëdhënës/e, pa arsye, nuk mund të përjashtojë dikë nga mundësia për të punuar, për t'u ngritur në detyrë, për t'u organizuar në sindikatë, për mbrojtje shëndetësore dhe shoqërore. Gratë marrin mbrojtje të veçantë në punë gjatë shtatzënisë dhe amësisë, po kështu edhe fëmijët mbi moshën 16-vjeçare që kanë të drejtë të punojnë.

Diskriminimi në arsim. Të gjithë nxënësit dhe studentët duhet të kenë mundësi të arsimohen pa u diskriminuar. Kështu, p.sh.: një fëmijë me autizëm nuk mund t'i mohohet pranimi në shkollë; dikujt tjetër vetëm pse është vajzë nuk mund t'i vihen nota më të ulëta në një shkollë ushtarake apo teknike; pse është nga bashkësia rome nuk mund t'i jepet një masë disiplinore apo të përjashtohet nga shkolla. Vlerësimi për nxënësit duhet të lidhet vetëm me aftësitë dhe veprimet që kryen nxënësi, por jo me shkaqet e diskriminimit të përmendura më lart.



Shteti ka për detyrë të marrë masa që asnjë fëmijë të mos lihet pa arsim, sidomos vajzat, fëmijët që nuk kanë mundësi ekonomike, ata që u përkasin pakicave dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo do të thotë që shteti duhet të ndihmojë familjet që nuk kanë mundësi ekonomike me libra, ndihmë ekonomike, transport dhe nganjëherë edhe me dokumente regjistrimi për fëmijët që ata të ndjekin shkollën. Kjo do të thotë që edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të ndjekin shkollat me moshatarët e tyre dhe të mësojnë në përputhje me aftësitë e tyre. Ata duhet të kenë mësues/e ndihmës/e shtesë por edhe një kujdes të veçantë nga të gjithë që të mos ndihen të përjashtuar. Fëmijët të cilët iu përkasin pakicave etnike, kanë të drejtën të arsimohen në gjuhën e tyre.

Organet shtetërore dhe arsimore kanë detyrë që t'i informojnë fëmijët dhe nxënësit/et për mbrojtjen nga diskriminimi dhe të luftojnë çdo sjellje diskriminuese, veçanërisht në mjediset shkollore dhe gjatë proceseve mësimore.

Shkolla duhet të jetë një mjedis i qetë, pranues, inkurajues dhe gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit pa dallim por edhe vetë mësuesit/et, ndaj ligji ndalon çdo lloj shqetësimi e sidomos shqetësimin seksual. Shqetësimi pse vishesh në një mënyrë të caktuar, për shkak se je vajzë, apo se vjen nga një pakicë, se vjen nga një rreth tjetër, se ke një aftësi të kufizuar, se je i varfër, etj. janë forma të dënueshme diskriminimi dhe mjaft të dëmshme për shoqet e shokët.

Nëse ndihemi të diskriminuar apo të shqetësuar nga mësuesit, nxënësit/et apo çdo punonjës tjetër i shkollës mund të ankohemi tek drejtori/ja i/e shkollës. Drejtori/ja është i/e detyruar që brenda 30 ditëve të marrë masat e nevojshme për rregullimin e situatës së krijuar. Këto ankesa mund të zgjidhen me ballafaqim dhe pajtim ndërmjet palëve, por mund të zgjidhen edhe me masa disiplinore ndaj mësuesve apo nxënësve që kanë kryer diskriminim.

Diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Për t'u integruar në jetën ekonomike dhe shoqërore të gjithë kanë të drejtë të përdorin shërbimet dhe të përfitojnë të mirat publike, si p.sh.: shërbimin shëndetësor, arsimimin, hyrjen në institucione publike dhe private, përdorimin e parqeve apo mjediseve publike, marrjen e ndihmës ekonomike, punësimin, strehimin, përdorimin e mjeteve të transportit publik, shitblerjen dhe dhënie me qira të pronave me qëllim fitimi, etj. Përfitimi i barabartë i shërbimeve nga personat me aftësi të kufizuara kërkon ndër të tjera përshtatjen e mjediseve që ky person të ketë mundësi të hyjë lirisht në godinat publike dhe private si edhe në mjetet e transportit publik; marrjen e ndihmës ekonomike nga të pamundurit, pakicat, etj. Mundësia e barabartë për të marrë mallra dhe shërbime cilësore u jep qytetarëve dinjitet dhe mundësi për një jetë më të mirë.

Ligji mund të vendosë edhe kufij moshorë për marrjen e disa të mirave dhe shërbimeve. Fjala vjen, një restorant mund të mos pranojë t'i shërbejë alkool një fëmije (nën 18 vjeç) dhe në këtë rast ky nuk përbën diskriminim të paligjshëm.



Ku të drejtohem për diskriminim ndaj meje?

Trajtimi i barabartë ose mosdiskriminimi është detyrë shoqërore dhe ligjore. Ne duhet të kërkojmë të trajtohem pa dallim nga të tjerët në çdo mjedis ku ndodhemi, qofshin publike apo private. Nëse drejtuesit e institucionit ku ankohemi nuk marrin masa për ta ndrequr situatën dhe nëse diskriminimi vazhdon, ne mund të ankohemi te Komisioneri/ja për Mbrojtjen nga Diskriminimi ose në gjykatë.

Nëse diskriminimi ndodh në shkollë, fëmija duhet t'i drejtohet mësuesit/es ose drejtuesit/es të institucionit ku ndodh diskriminimi.

Një fëmijë mund t'i drejtohet drejtpërdrejt edhe Komisionerit. Ai/ajo mund të shkojë i/e përfaqësuar nga prindi, kujdestari ligjor ose një shoqatë.

Komisioneri/ja zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë, është i pavarur në punën e tij/saj dhe i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit. Komisioneri/ja ka një zyrë me punonjës të specializuar me qendër në Tiranë, por ka edhe disa zyra në Korçë, Fier dhe Shkodër dhe përmes tyre mbulon të gjithë Shqipërinë. Komisioneri/ja qëndron në detyrë 5 vjet, kohë pas së cilës Kuvendi zakonisht zgjedh një Komisioner të ri.

Detyrat e Komisionerit janë të mbikëqyrë situatën e diskriminimit në vend, të përcaktojë nëse ka shkelje, të kërkojë që të ndryshojë ligji ose sjellja që çon te kjo shkelje, të urdhërojë ndalimin e praktikave të diskriminimit dhe të dënojë ata që e kryejnë atë me gjobë. Komisioneri mund të japë mendim të specializuar si ekspert para gjykatës, nëse ka pasur apo jo diskriminim në një çështje. Komisioneri/ja përgjigjet para Kuvendit për punën e tij. Po ashtu Komisioneri/ja raporton për ligjin, praktikën dhe sjelljen në Shqipëri, lidhur me mosdiskriminimin edhe para institucioneve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ku Shqipëria bën pjesë, si për shembull te Komiteti i Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Kush mund të ankohet te Komisioneri/ja?

Te Komisioneri/ja ankohen si individë ashtu edhe grupe ose organizata kur ata ndihen të diskriminuar. Ankesa e tyre mund të ngrihet, ndaj një personi, ndaj një institucioni publik apo privat. Komisioneri/ja përpiqet ta zgjidhë çështjen me pajtim mes palëve, por nëse ato nuk bien dakord, atëherë ai urdhëron ndalimin e sjelljes diskriminuese dhe mund të vendosë edhe gjobë.

Komisioneri/ja i ofron shërbimet e veta falas. Ti nuk ke nevojë të paguash diçka nëse paraqet një ankesë.



Si zhvillohet një çështje për diskriminim tek Komisioneri/ja?

Çështja te Komisioneri ngjan me një gjyq. Ankesa bëhet me shkrim ose edhe me gojë duke shkuar në zyrat e Komisionerit. Komisionerit mund t'ia dërgojmë ankesën me postë ose me email, si edhe nëpërmjet aplikacionit KMD App. Gjithashtu çdokush mund të marrë në telefon institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në numrin e gjelbër (fals) **0800 06 06**. Ankesa mund të bëhet nga një njeri, një grup njerëzish, një organizatë apo një shoqatë.

Ankesa nuk pranohet nëse: nuk ka lidhje me ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi"; kur çështja është shqyrtuar me një ankesë tjetër më parë; nuk ka baza dhe nuk ka fakte për të filluar një hetim; kur shkelja ka ndodhur para se ligji i diskriminimit të hynte në fuqi; kur ankesa bëhet më vonë se tre vjet nga shkelja apo më vonë se dy vjet nga informimi për diskriminimin.

Ku i gjejmë zyrat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi?

Tiranë: Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27. Tel: + 355 4 243 1078

Shkodër: ADISA, Rruga "Edith Durham". Tel: + 355 67 449 6586

Korçë: Rruga "28 Nëntori", Nr.1. Tel: +355 69 620 7371

Fier: ADISA, Lagjia "11 Janari". Tel: +355 69 516 1864

Si të na kontaktoni elektronikisht?

Vizitoni faqen tonë të internetit:
www.kmd.al



Na dërgoni postë elektronike në:
info@kmd.al



Nëpërmjet aplikacionit tonë
KMD App



Çfarë mund të përmbajë vendimi i Komisionerit/es?

Vendimi mund të urdhërojë:

- Ndërprerjen e një praktike të padrejtë;
- Ndryshimin e një rregulli të padrejtë;
- Ndalimin e sjelljes diskriminuese si dhe ndreqjen e situatës.

Kush nuk zbaton vendimin e KMD-së, ndëshkohet me gjobë. Gjopa duhet paguar detyrimisht brenda 45 ditëve.

Ecuria e një çështjeje për diskriminim

Rasti 1

1

Ankesa bëhet te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

2

Brenda 15 ditësh Komisioneri njofton palët për pranimin ose jo të çështjes.

4

Brenda maksimumi 90 ditësh Komisioneri merr **vendim**.

3

Brenda 10 ditësh palët dërgojnë sqarime me shkrim te Komisioneri.

Rasti 2

1

Ankesa bëhet në gjykatë 5 vjet nga ngjarja ose 3 vjet nga marrja dijeni për të.

2

Ankesa në gjykatë ndërpret procedurën e nisur nga Komisioneri.

3

Komisioneri merr pjesë në çdo proces gjyqësor për diskriminimin.

Përmbajtja e Ankesës

- Emrin dhe kontaktet e ankuesit
- Personin ose agjencinë që ka kryer diskriminimin
- Diskriminimin që thuhet se është kryer
- Masën që duhet të marrë Komisioneri
- Datën dhe firmën e ankuesit ose të avokatit të tij



Provoni njohuritë tuaja

1. SHKARTISJE SHKRONJASH

Gjeni fjalën e fshehur në fund të çdo fjalie duke përdorur shkronjat e shkurtisura

- Diskriminimi është _____ i padrejtë që na bëhet. (LIDAML)
- _____ krijon një mjedis frikësues, armiqësor, poshtërues a fyes. (QËMSTEHSI)
- Në shkollë fëmijët me aftësi të kufizuar duhet të kenë _____ (USMSËE IËNSDHM)
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi përgjigjet para _____ për punën e tij. (IVKDUTEN)
- Vendosja e një rregulli ose kriteri në mënyrë të tillë që mund ta përmbushin vetëm disa persona por jo të gjithë është _____. (KIMDINSIMIR I HTËOTRËRT)

2. ZGJIDHNI PËRGJIGJEN/T E DUHUR/A NDËR POHIMET E MËPOSHTME:

Te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mund të ankohet vetëm:

- a) një njeri
- b) një grup njerëzish
- c) një organizatë apo shoqatë
- d) cilido nga të mësipërmit

Kur drejtori/ja i/e shkollës merr një ankim për diskriminim, ai/ajo:

- a) ballafaqon palët
- b) zgjidh çështjen me pajtim
- c) merr masë disiplinore ndaj nxënësit që është ankuar
- d) merr masë disiplinore ndaj mësuesit a nxënësit që ka diskriminuar
- e) asnjë nga të mësipërmet

Kur një ankesë për diskriminim paraqitet edhe para gjykatës, edhe para Komisionerit:

- a) secili institucion vijon me shqyrtimin e çështjes – përderisa kanë marrë një ankesë duhet ta çojnë deri në fund
- b) gjykata tërhiqet – meqë Komisioneri është institucioni i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi
- c) Komisioneri tërhiqet – gjykata është organi më i lartë që jep drejtësi
- d) gjykata kërkon mendimin e Komisionerit për një çështje – ai/ajo është ekspert në fushën e mosdiskriminimit

3. E VËRTETË APO E GABUAR?

Shenjoni të duhurën në pohimet e mëposhtme:

	E vërtetë	E gabuar
▪ Komisioneri i ofron shërbimet e veta falas.	☐	☐
▪ Komisioneri nuk ka asnjë afat për shqyrtimin e një anese.	☐	☐
▪ Gjuha e urrejtjes nuk është diskriminim.	☐	☐
▪ Komiteti i Konventës për të Drejtat e Fëmijës nuk mund të pranojë raportime nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për gjendjen e fëmijëve në Shqipëri.	☐	☐
▪ Ankesa për diskriminim nuk pranohet nëse ngjarja ka ndodhur para hyrjes në fuqi të ligjit „Për mbrojtjen nga diskriminimi“.	☐	☐
▪ Komisioneri përgjigjet para Qeverisë për veprimtarinë e vet.	☐	☐
▪ Mbrojtja e posaçme për fëmijët dhe gratë shtatzëna nuk është diskriminim.	☐	☐
▪ Komisioneri pranon ankesa anonime.	☐	☐
▪ Dikush mund të diskriminohet vetëm për shkaqet e përmendura në ligj por jo për shkaqe të tjera.	☐	☐

4. GJENI NË PYLLIN E FJALËVE KËTO TË MËPOSHTMET:

TË DREJTA, PAKICA, BARAZI, ANKESË, SHQETËSIM, GJOBË, MOSDISKRIMINIM

F	T	D	X	Ë	M	E	P	P	Ë	H	O	Q	V	G
F	Ë	C	Q	B	S	A	B	B	J	B	U	X	B	J
R	D	T	V	N	K	E	O	N	T	N	N	E	L	J
O	R	R	E	I	A	J	K	J	U	M	G	R	V	Z
I	E	U	C	X	G	F	Y	N	W	I	F	F	K	C
A	J	A	Y	H	T	B	G	N	A	S	Q	L	E	I
M	T	D	K	R	E	D	T	I	H	Ë	B	X	R	T
D	A	O	Y	M	M	T	Q	E	V	T	R	J	R	C
O	Y	D	Q	Y	J	I	R	E	E	E	W	V	T	J
L	Y	H	I	Z	A	R	A	B	Y	Q	O	R	V	I
H	H	X	W	B	V	A	V	F	D	H	U	R	D	I
O	L	J	A	W	R	D	P	M	X	S	P	I	T	D
M	O	S	D	I	S	K	R	I	M	I	N	I	M	E
C	B	R	U	N	B	E	L	H	Y	U	D	N	E	Z
S	V	J	L	D	Q	G	L	B	R	A	U	Q	K	W

Si të mësojmë më shumë?

Tekstin e plotë të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi e gjeni këtu:

<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/2.pdf>

Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës e gjeni këtu:

http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2014/02/Konventa_per_te_drejtat_e_femijeve_shqip.pdf

Formatin e ankesës që mund të paraqisni te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e gjeni këtu: <https://www.kmd.al/si-mund-te-ankoheni/>

Përgjigjet e pyetjeve të testit i gjeni pranë mësuesit/eses

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi Përmbledhje për Fëmijë



Norwegian Embassy



UNITED NATIONS
ALBANIA

